



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Komuna e Kisella Vodës

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2021.

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa aktivitetet dhe transaksionet që reflektohen janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- jo transparent në procedurat dhe kriteret për angazhimin e personave për kryerjen e punëve publike dhe pagesa pa bazë e mjeteve në bazë të kontratave për të drejtën e autorit;
- rikonstruimi dhe sanimi i rrugicave dhe rrugëve lokale pa përgatitur dokumentacionin e projektit dhe miratimin e dhënë për ndërtim;
- parregullsi në zbatimin e prokurimeve publike.

Mendimi i dhënë*:

Shprehëm mendim të pavolitshtëm për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (637) për vitin 2021 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- përcaktimi i politikave për nevojat e angazhimit të personave në bazë të kontratave në vepër dhe angazhimi i personave për kryerjen e punëve publike, përcaktimi i kriterëve për caktimin e shumës së kompensimit;
- planifikimi dhe realizimi i ndërtimeve të bazohet në dokumentacionin e projektit dhe miratimin e dhënë për ndërtim;
- përgatitja e specifikacioneve teknike në pajtim me dokumentacionin e projektit, përcaktimi i kërkesave proporcionale në pajtim me landën e prokuruar dhe sigurimi i të gjitha dokumentacioneve të nevojshme gjatë përcaktimit të aftësisë së operatorëve ekonomik.

Dobësitë kyçe të sistemit:

/

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtjet janë shqyrtuar dhe nuk janë pranuar për shkak se nuk janë marrë dëshmi shtesë që do të ndikonte në konstatimet e raportit.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga ana e kryetarit të mëparshëm të Komunës së Kisella Vodës janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror nr. 16-77/2 nga 16.01.2023.

*



pozitive,



me rezervë



të pavolitshtëm



të përmbajtur